



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
MINISTRI

Nr. 3848 Prot.

Datë 05.10.2022

UDHËZIM

Nr. 564, Datë 05/10/2022

PËR

“MIRATIMIN E STANDARDEVE PËR QENDRAT E TRAJTIMIT TË FËMIJËVE  
VIKTIMA APO DËSHMITARË TË ABUZIMIT SEKSUAL DHE FORMAVE TË RËNDA  
TË DHUNËS”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 të nenit 27 dhe 51 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;

URDHËROJ:

1. Miratimin e standardeve për qendrat e trajtimit të fëmijëve viktima apo dëshmitarë të abuzimit seksual dhe formave të rënda të dhunës, emergjent, me një ndalesë, në mënyrë të integruar, 24/7 dhe afatshkurtër, të vendosura pranë qendrave spitalore, sipas dokumentit, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.
2. Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror siguron inspektimin e zbatimit të standardeve, nga subjektet publike dhe jopublike të licencuara.
3. Shërbimi Social Shtetëror siguron monitorimin e zbatimit të standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej strukturës së posaçme për shërbimet e kujdesit shoqëror, apo dhe/ose personave juridik publik/privat, që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror, të cilat financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit.



4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, Inspektorati përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror si dhe qendrat sptalore pranë të cilave do të ngrihet ky shërbim, për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR**

**OGERTA MANASTIRLIU**



